



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:227368
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05753536

KPPP.nr.1695/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës, me adresë në Prishtinë, kundër debitorit NTP Demping, me adresë në fshatin Vitak, Komuna e Skënderajit, me NRB: 80057881, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Visar Rrecaj me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përbarimor P.nr.4125/18 të datës 05.12.2018, të Përbaruesit Privat Isa Gacaferi, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 10.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit NTP Demping, Urdhri Përbarimor P.nr. 4125/18 i datës 05.12.2018, i lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.4125/18 të datës 05.12.2018, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturës nr.B-43/2017 të datës 20.08.2017, B-43/2016 të datës 20.08.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve sipas faturave të lartcekura, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, t'ia paguaj

kreditorit shumën prej 888.00 Euro, si dhe të gjitha shpenzimet përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka theksuar se urdhri përmbartimor mbështetet në faturën e cila është drejtuar gabimisht te debitori NTP DEMPING me pronar Z.M., ani pse fatura i drejtohet me emër debitorit të dytë H.H.. Më tej ka theksuar se Përmbartuesi Privat nuk lëshohet fare në konstatimin e gjendjes faktike lidhur me obligimin e debitorit të parë ndaj kreditorit, por vetëm e lejon urdhrin sipas propozimit të kreditorit, siç shihet në dokumentet e bashkangjitura në urdhër kemi faturat të cilat i janë drejtuar debitorit të dytë me emër dhe mbiemër. Ka shtuar se Z.M. dhe kompania e tij nuk kanë pasur dhe nuk kanë legjitimitet pasiv për të qenë palë debitore, për faktin se z.H. është dhe ka qenë pronar i objektit pompë derivatesh edhe sipas vendimit të KK Skënderaj për Legalizim nr.351/92 të datës 07.09.2023, pra obligimi i kreditorit bie tek debitori i dytë sepse ky i fundit ka kontratë me kreditorin dhe është pronar i tokës dhe objektit afarist, ndërsa z.M. dhe firma e tij me qera e kanë shfrytëzuar pompën dhe truallin, të cilën e ka paguar tek z.H.. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi në tërësi si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet si dhe të pezullohen të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me përmbartimin.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.B-43/2017 e datës 20.08.2017, B-43/2016 e datës 20.08.2016, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-

së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr.B-43/2017 e datës 20.08.2017, dhe fatura nr.B-43/2016 e datës 20.08.2016, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar urdhri përmbarrimor janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarrim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarrimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.4125/18 i datës 05.12.2018, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarrim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarrimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u theksua më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1695/23, më datë 10.05.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.